

KUD: 323.1(496.51) "1998"
061.1(4/9:497.115) :355 (093.3)
94 (496.51) "1998"

Arbër HADRI

**ULTIMATUMI I PRESIDENTIT BILL CLINTON DHE
PËRGATITJET PËR INTERVENIMIN USHTARAK NË KOSOVË
(SHTATOR-TETOR 1998)**

Punimi shkencor “Ultimatumi i presidentit Bill Clinton dhe përgatitjet për intervenimin ushtarak në Kosovë (shtator-tetor 1998)”, trajton një temë shumë të rëndësishme për historinë më të re të Kosovës, përfshirjen e Shteteve të Bashkuara në zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe ecurinë e vendimit për intervenim ushtarak.

Kjo temë dhe veçoritë e saja, nuk janë trajtuar më parë në historiografinë shqiptare. Me këtë rast synojmë që të paraqesim rezultate të reja historiografike, të mbështetura në dokumente burimore të institucionit më të lartë amerikan për politikë të jashtme dhe siguri kombëtare, “Këshillit të Sigurisë Kombëtare”.

Eskalimi i situatës së sigurisë në Kosovë në pjesën e dytë të vitit 1998, përfshiu politikën amerikane në formë direkte me synim të parandalimit të luftës në Kosovë, vendosjes së paqes dhe gjetjes së një zgjidhjeje politike për statusin e ardhshëm të Kosovës. Interesat e sigurisë kombëtare amerikane ishin prekur, meqë kontingjenti ushtarak i saj gjendej në afërsi të Kosovës, në Bosnjë-Hercegovinë. Po ashtu, kredibiliteti i institucioneve politike e ushtarake ndërkombëtare ishte vënë në pikëpyetje, shenjat e katastrofës humanitare ishin evidente në terren në Kosovë, si dhe kishte presion të jashtëzakonshëm medial ndaj qeverisë amerikane për veprim. Periudha e muajve shtator dhe tetor të vitit 1998, si rezultat i ofensivave ushtarake serbe dhe ashpërsimit të situatës rrënuese në terren, shënon një kaptinë të veçantë në aspektin e vendosmërisë së politikës amerikane drejt ndalimit të mizorive të policisë dhe ushtrisë

serbe në Kosovë, duke përfshirë edhe nxitjen e intervenimit ushtarak të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (North Atlantic Tractact Organization - NATO). Kjo qasje, ishte në linjë me krijimin e një platforme dhe mundësie përfundimtare politike, për ndërprerjen e luftimeve dhe arritjen e një marrëveshjeje paqësore.¹

Ultimatumi² i presidentit Klinton i nxjerrë më 28 shtator 1998, parandaloi për një periudhë shkallëzimin e luftës dhe katastrofën humanitare në Kosovë. Pasojat humanitare dhe viktimat në njerëz do të mund të ishin edhe më të mëdha në përmasa, se ato pasuese, meqë kushtet atmosferike të atij viti ishin shumë më të ashpra, si dhe planifikimet ushtarake të NATO-s e aleatëve, ishin në fillet e saj.

Ultimatumi përfshinte planifikimet emergjente ushtarake dhe humanitare, si dhe kërcënimin e intervenimit ushtarak në Kosovë nëpërmjet nxitjes së NATO-s për marrjen e vendimeve të “Kërkesës për Aktivizim”³ (“Activization Request” - ACTREQ) dhe “Urdhrit për Aktivizim”⁴ (“Activation Order” - ACTORD). Këto dy shkallë iniciuese për veprim të NATO-s, ishin të nevojshme për fillimin e sulmeve ajrore kundër Serbisë agresore.

Situata në teren në Kosovë në këtë kohë ishte shpërthyesë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) dhe lëvizja paqësore, ishin kategorikisht kundër çdo zgjidhjeje që parashihte autonominë përpos pavarësisë së plotë të Kosovës. Qëndrime diametralisht të kundërta i kishte shteti i Serbisë, i cili e shihte popullin shqiptar në Kosovë, si një kërcënim për projeksionet

¹ Arbër Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare i SHBA: Lufta në Kosovë - Dokumente shtetërore-publike të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, Kosova Vëllimi I (19 qershor 1998-31 tetor 1998)* (Prishtinë: SHBAH, 2020), 35.

² *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC) - Shtëpia e Bardhë, Doc. 6519, “Memorandum për presidentin - Kosova: Përgatitja për ultimatum”, përpiluar nga Këshilltari i Sigurisë Kombëtare Samuel Berger, 24 shtator 1999, Vashington; Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare*, 154-159.

³ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20844, “Përmbledhja e konkludimeve për mbledhjen e drejtorëve të Komitetit për Kosovën të Këshillit të Sigurisë Kombëtare”, 30 shtator 1998, 2:45 – 4:15 P.M., Dhoma e Situatës, Uashington, f. 1-2.

⁴ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc. 20865, “Përmbledhja e konkludimeve për mbledhjen e zëvendës drejtorëve të Komitetit për Kosovën të Këshillit të Sigurisë Kombëtare për Kosovën”, 6 tetor 1998, 7:15 – 7:45 A.M., Uashington, f. 1-2.

e saja nacionaliste dhe ekspansioniste në Ballkan. Ky synim u dëshmuar që nga fillimi i viteve të '80-ta, me instalimin e apartheitit shtetëror serb dhe shtypjen e lirive të njeriut në Kosovë; ndrydhjen e identitetit kulturor, arsimor e shkencor; suprimimin e autonomisë politike të Kosovës; spastrimin etnik dhe vrasjet makabër, si dhe aktet gjenocidiale që pushteti serb në formë të organizuar e të qëllimshme i realizoi në Kosovë. Njëpërmjet këtyre veprimeve, regjimi serb i Sllobodan Millosheviqit kishte për qëllim zbatimin e misionit të tij për rikonfigurimin etnik të Kosovës, në favor të Serbisë.⁵

Sjellja në një linjë e këtyre qëndrimeve diametralisht të kundërta të Kosovës dhe Serbisë, ishte një sfidë e madhe edhe për politikën e jashtme amerikane, e cila ishte në një presion medial të brendshëm për veprim, me qëllim të ndaljes së katastrofës humanitare dhe masakrave të popullit shqiptar të Kosovës, si dhe parandalimit të rrezikut për destabilizim në rajon dhe Evropë. Një element i rëndësishëm që ndikoi në përkushtimin dhe determinimin e administratës amerikane për ta ndaluar luftën dhe t'i jap kaheje zgjidhjes së Kosovës, ishte eksperiencia jo e mirë me Bosnjën⁶ ku kishte më shumë se njëqindmijë⁷ persona të vrarë dhe fytyra e nacionalizmit Millosheviqian ishte demaskuar tërësisht. Qëndrimi i prerë i presidentit Klinton, ishte se “nuk do të lejonte një Bosnjë të dytë të ndodhte në zemër të Evropës në prag të shekullit XXI”.⁸

Gjendja e luftimeve në terren si dhe e vlerësimit ushtarak, pasqyrohet në analizën e Agjencisë Qendrore të Inteligjencës (Central Intelligence Agency - CIA) me rastin e informimit që i është ofruar ligjvënësës amerikane, Republikanes Heather Wilson më 29 shtator 1998. Me këtë rast kongresmenja Uillson është përditësuar mbi situatën aktuale

⁵ Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare*, 72-75.

⁶ William J. Clinton, *Public Papers of the Presidents Of The United States* (Washington; US Government Printing Office, 1993), Administration of William J. Clinton, Book I, “Remarks at a Town Meeting in Detroit”, February 10, 1993, 79.

⁷ Victor Toom, “Ontologically dirty knots: The production of numbers after the Srebrenica genocide”, *Security Dialogue* Volume 51/Issue 4 (2020): 358-359; Seybot TB, Aronson JD and Fischhoff B, *Counting Civilian Casualties: An Introduction to Recording and estimating nonmilitary deaths in conflict* (Oxford: Oxford University Press, 2013), 3-6; 213-246.

⁸ Bill Clinton, *My Life* (UK: Arrow Books, 2005), 848-851; William J. Clinton, *Public Papers of the Presidents of the United States January 1– June 30, 1999* (Washington; US Government Printing Office, 1993), Administration of William J. Clinton, Book I, “Remarks on the NATO Airstrikes Against Serbian Targets and an Exchange with Reporters March 28, 1999”, f. 462; Më tej, do të përdoret termi i shkurtuar Bosnjë, për Bosnjë dhe Hercegovinën.

në Kosovë, respektivisht vlerësimin e forcave dhe dobësive të Ushtrisë së Federatës Jugosllave (Serbi - Mali i Zi, më tej Jugosllavi) dhe të UÇK-së, si dhe rezultatet e mundshme të luftës. Po ashtu, u trajtuan edhe mizoritë e raportuara, shkeljet e armatosura ndaj armëpushimit të fundit, si dhe reagimet nga Aleatët e NATO-s në thirrjen amerikane për intervenim ushtarak në Kosovë, nëse shkeljet serbe të armëpushimit do të vazhdonin.⁹

Lidhur me madhësinë e forcave serbe në zonë dhe operacionet e tyre, informacionet e CIA-së jepnin indikacione se të njëjtat, në ato momente operonin, kryesisht në veri të maleve të Çiçavicës dhe në rajonin e Mitrovicës. Po ashtu, kishte trupa ushtarake të reja në rajonin e Ferizajt që sugjerorin që atje do të kishte aksione ushtarake në të ardhmen e afërt. Gjithashtu kishte aktivitete të raportuara në Suharekë. Në këtë momentum, sipas raportit cilësohej se Millosheviqi kishte pikëpamjen se e ka thyer UÇK-në, mirëpo sipas analizës së CIA-së ai ishte gabim, meqë struktura e Komandës së UÇK-së ishte e paprekur, duke pritur që Ushtria Jugosllave (UJ) të tërhiqej dhe të thyhej me sulmet ndaj saj në linjat e furnizimit. Veprimet ndëshkuese të forcave serbe kishin elektrizuar popullin shqiptar në Kosovë dhe qëndrimi analitik i CIA-së për periudhën e fundit të shtatorit të vitit 1998 ishte se pas luftimeve të verës “kishin mbetur rreth 5-8 mijë luftëtarë të UÇK-së në kodra dhe që morali i UÇK-së mbetej i fortë, disa furnizime vazhdonin të kalonin, por ata ishin në mangësi të municionit”. Kishte dëshmi se UÇK-ja po depëronte në disa nga zonat që kanë humbur më herët. Sipas CIA-së për të mbajtur UÇK-në në arrati, serbët do të duhej të ndërmerrenin spastrime të vazhdueshme ushtarake, gjersa për të shkatërruar UÇK-në sipas këtij raporti, “serbët do të duhej të shkonin lart në kodra, për të cilin aksion ata nuk kishin fuqi ushtarake të mjaftueshme dhe nuk ishin të trajnuar, po ashtu, shumica e njësive në Kosovë ishin me gjysmë të forcës, si dhe ata po përjetonin vështirësi në mobilizimin e më shumë trupave”. Pikëpamja e CIA-s, ishte se në të ardhmen e afërt do të “kishte një ngadalësim relativ të luftimeve, po ashtu, edhe për shkak të motit të dimrit. UÇK-ja do të qëndronte ulët për aq kohë sa grupet e luftimit të Ushtrisë Jugosllave mbeshnin jashtë në rrugët kryesore. Për luftimet në rajonet kufitare me Shqipërinë, CIA-ja parashikonte se do të vazhdonin dhe do të intensifikoheshin. Në këtë kohë, nuk kishte asnjë shenjë që Ushtria Jugosllave planifikonte ndonjë gjë

⁹Archive of Central Intelligence Agency (CIA), “Memorandum for the Record”, Doc. c/98-06145: date: 09/29/1998, qasur më 19 maj 2022, <https://www.cia.gov/readingroom/document/0001250240>; Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare*, 39-40.

përtej operacioneve të spastrimeve aty ku UÇK-ja ringjallej. Udhëheqja e UJ-së shpresonte se duke vulosur kufijtë, UÇK-ja do të zbehej”¹⁰

Sipas analizës së CIA-s, sfida e UÇK-së ishte që të përmirësohej në mënyrë ushtarake, të cilën po e adresonin nëpërmjet riorganizimit, forcimit të strukturës komanduese dhe furnizimit me armë më të mira. Pikëpamja e CIA-së ishte se në këtë kohë pritej që UÇK-ja do të ndërmarre disa sulme guerile sporadike dhe të intensitetit të ulët, veçanërisht nëse UJ-ja tërhiqej nga rrugët kryesore, por nuk do të kishte luftime të mëdha. Po ashtu, kjo analizë parashikonte se nëse UÇK-ja me sukses do të furnizonte veten deri në pranverën pasuese, lufta ndërmjet forcave serbe dhe UÇK-së do të rifillonte në atë kohë.¹¹

Çështja e intervenimit ushtarak të NATO-s në Kosovë ishte vu në radhitjen prioritare të politikës së jashtme amerikane. Tanimë, kjo agjendë ishte në binarë të zgjidhjes politike dhe ushtarake, e në këtë aspekt u përfshinë në lëvizje edhe agjencitë ndërshtetërore duke vepruar me zhvillimin e udhëzimeve të duhura për Misionin e Shteteve të Bashkuara në NATO, me qëllim të inicimit të procesit formal të gjenerimit të operacioneve ushtarake ajrore.¹²

Ky skenar i imponuar ndikoi në përfshirjen e organit më të lartë të politikës së jashtme dhe të sigurisë amerikane, Këshillit të Sigurisë Kombëtare.¹³ Një qasje e tillë serioze nënkuptonte edhe gjetjen e zgjidhjes së domosdoshme për ndaljen e luftës në Kosovë dhe marrëveshjes politike të palëve të përfshira në konflikt. Një numër i madh mbledhjesh të veçanta të këtij institucioni u zhvilluan midis qershorit të vitit 1998, deri më mars të vitit 1999 kur nisen bombardimet ushtarake të NATO-s, nën udhëheqjen

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty.

¹² Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare*, 72-75.

¹³ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20552, “Përmbledhja e konkludimeve për mbledhjen e drejtorëve të Komitetit për Kosovën të Këshillit të Sigurisë Kombëtare”, 19 qershor 1998, 6:00 – 7:30 P.M., Uashington. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi Samuel Berger; për zëvendës-presidentin Leon Fuerth, Leslie Davidson; Departamenti i Shtetit sekretarja Medeleine Albright, Strote Talbott, Ambassador Robert Gelbart; Mbrojtje: Sekretari William Cohen, Berndt McConnell; SHBA-OKB: ambasador William Richardson, Nancy Soderberg; CIA George Tenet, (... klasifikuar); Shtabi i Komandantëve të Bashkuar: Hugh Shelton, BG George Kasej; Shtëpia e Bardhë Gjim Steinberg, Donald Kerrik; Këshilli i Sigurisë Kombëtare Jock Covey.

e SHBA-së. Në këtë institucion u planifikua skenari i drejtimit dhe epilgut të luftës në Kosovë, duke përfshirë edhe dimensionin ushtarak.¹⁴

Këshilli i Sigurimit Kombëtar (National Security Council - më tej NSC) ishte në qendër të sistemit presidencial të koordinimit të politikës së jashtme dhe sigurisë kombëtare.¹⁵ Administrata e presidentit Klinton ka vazhduar të ketë në spikamë zhvillimin e një politike të jashtme amerikane të udhëhequr nga çështjet e sigurisë kombëtare.¹⁶ Këshilltari për siguri kombëtare Samuel R. Berger – “Sand”, u emërua¹⁷ në këtë detyrë në vitin 1997, në një periudhë vendimtare për ecurinë e proceseve politike dhe të sigurisë në Kosovë. Roli i tij në udhëzimin e presidentit, si dhe udhëheqjen e ekipit presidencial të NSC-së, i ngarkuar me politikë të jashtme dhe siguri, do të ishte me rëndësi të veçantë. NSC-ja, përbëhej nga zyrtarët kryesor shtetërorë: Këshilltari për Siguri Kombëtare, si udhëheqës i tij; sekretarja e Shtetit Madeleine Albright; sekretari i Mbrojtjes William Cohen; ambasadori i SHBA-së në OKB William Richardson; drejtori i CIA-së Tenet; Shtabi i Komandantëve të Bashkuar (Joint Chiefs of Staff): gjeneralët Hugh Shelton, George Kasej; përfaqësuesi i Misionit të SHBA-së në NATO gjenerali Clark, në rastin e Kosovës përfshihej përfaqësuesi special, ambasadori Richard Hollbrooke dhe ambasadori Christopher Hill; si dhe një mori zyrtarësh të tjerë të lartë të administratës së SHBA-së,¹⁸ të

¹⁴ Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare*, 21-22.

¹⁵ *Archive of the Congress of the United States*, “The National Security Act of 1947”, July 26, 1947, Public Law 253, 80th Congress; Chapter 343, 1st Session, S. 758.

¹⁶ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), “Presidential Decision Directive/NSC 2”, Doc 20003, January 20, 1993, “The White House”, Washington.

¹⁷ JAMES BENNET, “A TRUSTED ADVISER, AND A FRIEND: SAMUEL RICHARD BERGER”, *NEW YORK TIMES* (DECEMBER 6, 1996); ANTHONY LAKE PAPERS, “SENATE HEARING: MARCH 5, 1997”, *LIBRARY OF CONGRESS-WASHINGTON*, 10-17.

¹⁸ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20552, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të drejtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 19 qershor 1998, 6:00 – 7:30 P.M., Uashington. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi Samuel Berger; për zëvendëspresidentin Leon Fuerth, Leslie Davidson; *Departamenti i Shtetit* sekretarja Madeleine Albright, Strothe Talbott, Ambasador Robert Gelbart; *Mbrojtje*: Sekretari William Cohen, Berndt McConnell; *SHBA-OKB*: ambasador William Richardson, Nancy Soderberg; *CIA* George Tenet; *Shtabi i Komandantëve të Bashkuar*: Hugh Shelton, BG George Kasej; *Shtëpia e Bardhë* Gjim Steinberg, Donald Kerrik; *Këshilli i Sigurisë Kombëtare* Jock Covey.

cilët formësuan vendimet e ndërmarra nga presidenti Klinton, qëndrime të cilat ishin përcaktuese për fatin e Kosovës.

Menaxhimi i parandalimit të luftës në Kosovë, si dhe planifikimet emergjente ushtarake humanitare e përpjekjet diplomatike, ishin detyrat themelore të “Komiteti për Kosovën” në kuadër të Këshillit të Sigurisë Kombëtare Amerikane. Ky “Komitet” ishte një organ i veçantë i NSC-së, i cili ishte formuar për shkak të situatës së krijuar në Kosovë. Në mbledhjet të cilat ishin të karakterit vendimmarrës, përbëhej nga drejtorët, të cilët ishin pjesëtarët më të lartë udhëheqës të administratës amerikane të cekur më lart, si dhe në mbledhje të veçanta përgatitore nga zëvendësdrejtorët. Mbledhjet e NSC-së gjatë luftës në Kosovë, para intervenimit ushtarak të NATO-s, numëronin 84 takime për një periudhë nga 19 qershor 1998 deri më 20 mars 1999, që ishte një përfshirje e paprecedente në historinë e trajtimit të një çështjeje botërore të politikës së jashtme amerikane.¹⁹

Në shërbim të mundësisë së intervenimit ushtarak të NATO-s, për shkak të gjendjes në terren në Kosovë në muajin shtator 1998,²⁰ ishin vënë në lëvizje edhe agjencitë ndërshtetërore duke vepruar me zhvillimin e udhëzime të duhura për Misionin e SHBA-së në NATO, respektivisht për inicimin e procesit formal të gjenerimit të operacioneve ajrore.²¹ Në planin diplomatik, ambasadori Christopher R. Hill, ishte ngarkuar që t’i vazhdojë përpjekjet e tij për arritjen e një marrëveshjeje politike paqësore. Po ashtu, në këtë stad kohor, ishte ndërmarrë një planifikim i detajuar i një paramarrëveshjeje për Kosovën nga ana e Qeverisë amerikane, duke adresuar edhe rrethanat në të cilat SHBA-ja do të duhej të angazhohej për përdorimin e forcës, planifikimet e përdorimit të llojit të forcës, si dhe pasojat e mundshme në terren.²² Në këtë kontekst, u miratua një qasje gjithëpërfshirëse e planifikimit humanitar dhe ushtarak për detyrimin e Millosheviqit për evitimin e katastrofës humanitare dhe në funksion të një zgjidhjeje politike për çështjen e Kosovës.²³ Planifikimi ushtarak për

¹⁹ Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare*, 21.

²⁰ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20750, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendësdrejtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 04 shtator 1998, 11:00- 12:30 P.M., Uashington.

²¹ Po aty.

²² Po aty; Christopher Hill, *Outpost: Life on the frontlines of American diplomacy* (New York: Simon & Schuster, 2014), 120-144.

²³ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National

kontributin e SHBA-së në planin e fushatës ajrore të NATO-s u përshpejtua, duke shqyrtuar mundësinë nëse Qeveria e SHBA-së duhet të udhëhiqte NATO-n në dhënien e ultimatumit Serbisë,²⁴ e pasuar nëse është nevojshme nga përfshirja në faza e fuqisë ajrore, me objektiv të detyrimit të Millosheviqit për marrjen e hapave konkret për anashkalimin e katastrofës humanitare dhe realizimit të marrëveshjes politike.²⁵

Në fund të shtatorit²⁶ dhe fillim të tetorit të vitit 1998, administrata amerikane kishte realizuar përgatitjet për planifikimet ushtarake të SHBA-së nën ombrellën e NATO-s, marrjen e vendimit të “Kërkesës së Aktivizimit (Activation Request - ACTREQ) si dhe më pas të “Urdhrit të Aktivizimit” (Activation Order - ACTORD) nga ana e NATO-s. Këto veprime ishin elemente të qasjes së real politikës së SHBA-së, të cilat tani vështroheshin nën variantin e zgjidhjes me mjete ushtarake të problemit të Kosovës, nëpërmjet intervenimit ushtarak të NATO-s.²⁷ Ky qëndrim i politikës amerikane ishte në linjë me krijimin e një platforme dhe mundësie përfundimtare politike, përballë kërcënimit real ushtarak ndaj Millosheviqit, në funksion të ndërprerjes së luftimeve dhe dhënien e mundësisë për marrëveshje politike paqësore.

Në këto rrethana u paraqit dokumenti udhërrëfyes i politikës së jashtme amerikane ndaj luftës në Kosovë dhe intervenimit ushtarak amerikan-NATO, në konditat e sigurisë së saj kombëtare. Ky dokument u definua me strategjinë e propozuar nga Këshilltari i Sigurisë Kombëtare Samuel Berger dhe anëtarët e NSC-së,²⁸ më 24 shtator 1998, në

Security Council – NSC), Doc 20761, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendësrejtoreve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 9 shtator 1998, 2:30 - 4:00 P. M., Uashington.

²⁴ Termi Serbi, përdoret përkundër faktit se e njëjta ishte në kuadër të shtetit të përbashkët me Malin e Zi - Federatën Jugosllave. Kjo ngase, Mali i Zi mbahej pa dëshirën e tij decrive dhe tentonte të mbante një qëndrim neutral në çështjen e përfshirjes në luftimet në terren në Kosovë. Shumica dërmuese e forcave ushtarake dhe policore të përfshira në luftime dhe masakra të popullatës shqiptare ishin nga Serbia.

²⁵ Po aty.

²⁶ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20829, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendësrejtoreve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 26 shtator 1998, 10:30 - 12:00 P.M., Uashington.

²⁷ Po aty.

²⁸ Duke përfshirë edhe insistimin e gjeneralit Klark, me rastin e takimit me presidentin Klinton, më 15 shtator 1998, si dhe me pjesëtarë të lartë të Departamentit të Mbrojtjes, Pentagonit dhe Shtabin e Komandantëve të Bashkuar, se ishte e domosdoshëm hartimi dhe nxjerrja e një “Ultimatumi” drejtuar Millosheviqit për parandalimin e shkatërrimeve,

Memorandumin e titulluar “Kosova: Përgatitja për ultimatum”.²⁹ I njëjti u miratua për zbatim nga presidenti Klinton. Qëllimi primar i këtij ultimatumit ishte definimi i opsioneve për shmangien e një katastrofe humanitare në Kosovë dhe promovimin e një zgjidhjeje politike.³⁰

Me afrimin e dimrit dhe me Millosheviqin ende mospërfillës, drejtorët e NSC-së ranë dakord që ishte koha që nëpërmjet një kërcënimi të besueshëm-ultimatumit që përfshinte intervenimin ushtarak të NATO-s, të mbështeteshin kërkesat ndërkombëtare për një zgjidhje politike të çështjes së Kosovës, si dhe dhënies fund të konfliktit. Parashikohej se nëpërmjet kësaj qasjeje, do të shtyhej NATO-ja në nxjerrjen e një ultimatumit, i cili do të kërkonte nga Millosheviqi të ndërmarrë hapa konkretë për të zgjidhur krizën humanitare dhe politike në Kosovë, ose përndryshe i njëjti do të përballlej me një reagim ushtarak të saj. Sipas kësaj strategjie, në mënyrë që ultimatumit të ishte i besueshëm, nëse Millosheviqi dështonte të bindej, SHBA-ja dhe aleatët e saj do të duhej të ishin të gatshëm për të kryer sulme të kufizuara me raketa fluturuese të dirigjuara ndaj Serbisë, si dhe Jugosllavisë në tërësi.³¹ Në këto kondita, memorandumit aludonte se, nëse Millosheviqi vazhdonte me mospajtueshmëri, SHBA-ja dhe aleatët do të duhej të ishin të gatshëm për përshkallëzimin e sulmeve ajrore të gjera, me objektivin e ndalimit të aftësisë së tij për të kryer operacione ushtarake dhe të sigurisë në Kosovë. Ky ultimatum, u përcaktua se duhej të ishte i shoqëruar edhe me një paralajmërim të ashpër ndaj shqiptarëve të Kosovës që t’i ndalin luftimet dhe të mos provokojnë, me veprimet e tyre luftarake në terren, një reagim ushtarak serb.³²

Këshilli i Sigurisë Kombëtare në këtë rast pati një konsensus të qartë se një qasje e fokusuar vetëm në ndihmë humanitare dhe negociata diplomatike nuk do të kishte perspektivë të arsyeshme për sukses dhe se

spastrimit etnik, refugjatëve dhe eskalimit të mëtutjeshëm të luftës në Kosovë; Wesley K. Clark “*Winning modern wars: Iraq, terrorism, and the American empire*” (New York: PublicAffairs, 2003), 131-137.

²⁹ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC) - Shtëpia e Bardhë, Doc. 6519, “Memorandum për presidentin - Kosova: Përgatitja për Ultimatum”, nga Samuel Berger, 24 shtator 1999, Washington; Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare*, 164-169.

³⁰ Po aty.

³¹ Sulmet ndaj pjesës tjetër të Jugosllavisë, Malit të Zi, kishin shënjestra më të kufizuara luftarake.

³² Po aty.

procesi negociator i ambasadorit Hill, ndërmjet Millosheviqit dhe shqiptarëve të Kosovës, nuk do të arrinte një marrëveshje të pranueshme për aq kohë sa dhuna vazhdonte. Kjo dhunë, sipas këtij dokumenti, ishte pasojë e operacioneve të zgjata dhe brutale të forcave serbe të sigurimit, si dhe e sulmeve sporadike të UÇK-së. Këto akte, në prizmin e memorandumit, do të vazhdonin të pengojnë përpjekjet për një zgjidhje paqësore të çështjes së Kosovës, si dhe kontribuonin në rrethin vicioz të dhunës mizore në terren.³³

Në këtë kuadër perceptohej edhe miratimi unanim i Rezolutës së bazuar në Kapitullin VII,³⁴ të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), si dhe vendimi i NATO-s për të filluar gjenerimin e forcave ushtarake për intervenimin ushtarak në Kosovë. Këto veprime, pjesë e vendimit të ultimatimit nga ana e presidentit amerikan, dërgonin një sinjal të fortë për Millosheviqin, si dhe ishin hapa të rëndësishëm për të përgatitur politikisht dhe ushtarakisht Shtetet e Bashkuara. Kjo Rezolutë, po ashtu krijonte një bazë politike të gjerë për intervenimin ushtarak ndërmjet aleatëve, mirëpo nuk autorizonte shprehimisht përdorimin e forcës. Kjo arritje e përkrahjes së Forcave Aleate, kërkonte një përpjekje të madhe, veçanërisht me Rusinë si kundërshtarë e fuqishme e çdo përdorimi të forcës, meqë shumë nga aleatët kishin pikëpamje se duhet kërkuar rrugë për një rezolutë tjetër të OKB-së, që autorizonte në formë specifike forcën, përpara se NATO-ja ta nxjerrë një ultimatum. Përkundër kësaj, SHBA-ja, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë “Memorandum-Ultimatum”, ishte decidive në arritjen e miratimit të Aleancës, për përdorimin e forcës me ose pa një rezolutë të re të OKB-së. Përpos kësaj vështirësie, në horizont shiheshin edhe obstrukcionet e Millosheviqit, nëse ai pajtohej vetëm pjesërisht me kushtet e ultimatimit.³⁵

Në kuadër të përgatitjeve për ultimatum, po ashtu parashihej sigurimi i mbështetjes së Kongresit, që konsiderohej si një çështje e një rëndësie të veçantë. Pikëpamja e grupit të politikës së jashtme, që realizoi dokumentin në fjalë, ishte se shumica e anëtarëve të Kongresit dhe publiku në përgjithësi, kishin interes të kufizuar për Kosovën, si dhe SHBA-ja kishte vështirësi në ruajtjen e mbështetjes për pjesëmarrjen në

³³ Po aty.

³⁴ Kapitulli VII i Kartës së Kombeve të Bashkuara, autorizon Këshillin e Sigurimit për ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me kërcënimet ndaj paqes, shkeljet e paqes dhe aktet e agresionit, me qëllim të ruajtjes ose rivendosjes së paqes ndërkombëtare dhe sigurisë.

³⁵ Po aty.

Stabilisation Force (SFOR) në Bosnjë. Kongresi, sipas strategjisë së përcaktuar në këtë Memorandum, do të ishte i shqetësuar për çfarëdo veprimi ushtarak, si dhe cilësohej si vënie e forcave amerikane në rrezik, apo që do të rezultonte në një angazhim ushtarak afatgjatë në mbështetje të “autonomisë së Kosovës”. Po ashtu, vlerësohej se Kongresi do të ishte veçanërisht i kujdesshëm në qoftë se Shtetet e Bashkuara do të përfshiheshin në një angazhim më të fortë për veprim ushtarak, sesa aleatët e saj evropianë. Ngurrimi i aleatëve, mund të shfrytëzohej si shkas nga disa anëtarë të Kongresit, për kritikimin e këtij qëndrimi të administratës. Përdorimi i fuqisë ajrore, konsiderohej se mund të angazhoj më vonë SHBA-në për të luajtur një rol në implementimin e marrëveshjes, ngaqë ajo të miratohej. Sipas Memorandumit, planifikimi i NATO-s për këtë veprim parashikonte një forcë prej 36 000 trupave, duke përfshirë 8 000 ushtarë në Shqipëri. Në këtë kontekst, cilësohej se duhej fokusuar për atë moment në eksploatimin e opsioneve të tjera për zbatimin e një marrëveshjeje paqësore, e cila do të vendoste besimin më të madh në ndërtimin e policisë lokale dhe të institucioneve të tjera, gjersa më pak në praninë e madhe ndërkombëtare, veçanërisht në praninë ushtarake në teren të SHBA-së.³⁶

Si brengë në Memorandum, pasqyrohej edhe rreziku se përdorimi apo edhe kërcënimi me forcë, do të mund të shkaktonte që Beogradi të ndërpresë përpjekjet e ndihmës dhe procesin negociator, duke rënduar kështu krizën humanitare, si dhe do të rriste rrezikun në ndonjë vend tjetër për viktima ushtarake, marrje të pengjeve apo masa ndëshkimore ndaj shtetasve ose interesave të SHBA-së. Përkundër kësaj, ishte pikëpamja e SHBA-së se shmangia e një katastrofe humanitare nëpërmjet një kërcënimi të besueshëm të forcës ushtarake, kishte një perspektivë shumë më të lartë për sukses krahasuar me një qasje thjesht humanitare dhe diplomatike, e cila nga këndvështrimi i NSC ishte një përpjekje e destinuar të dështojë dhe që do të minonte kredibilitetin e SHBA-së. Në këtë prizëm, “vetëm përgatitja për përdorimin e forcës do të mund ta bënte këtë politikë mjaft të besueshme, si dhe të rezultonte që Millosheviqi të tërhiqej dhe të negocionte seriozisht”.³⁷

Ky Memorandum u rekomandua dhe u nënshkrua nga presidenti Klinton, më datë 24 shtator 1998, duke ja dhënë dritën e gjelbër administratës amerikane, për t’u përgatitur për nxjerrjen e një ultimatumit të NATO-s, të mbështetur nga kërcënimi i përshkallëzuar i përdorimit të

36 Po aty.

37 Po aty.

fuqisë ajrore dhe të një strategjie të ndërlidhur diplomatike. Po ashtu, kjo qasje hapi dyert për veprimin përballë Kongresit dhe aleatëve, për ndërtimin e mbështetjes për ultimatumin e NATO-s dhe përpjekjeve për marrëveshje paqësore.³⁸

Menjëherë pas përcaktimit të qartë të presidentit Clinton, për një ultimatum drejtuar Millosheviqit, më 30 shtator 1998,³⁹ drejtorët e Komitetit për Kosovën, pranë Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, u pajtuan që Qeveria e SHBA-së duhet t'i bënte presion NATO-s, që e njëjta të autorizonte deri më 2 tetor, lëshimin e "Kërkesës së Aktivizimit" (ACTREQ) për opsionin e limituar ajror dhe fushatës ajrore në faza. Ky vendim, u pasua nga deklaratat publike e sekretarit gjeneral të NATO-s, që shpjegonte këtë veprim si reagim ndaj mizorive të fundit në Kosovë dhe moszbatimin e vazhdueshëm të obligimeve nga Beogradi, bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB 1199.⁴⁰ Po ashtu, u vu theksi për nevojën e një qasjeje të përbashkët të drejtorëve politik të Grupit të Kontaktit,⁴¹ lidhur me diskutimin "inter alia" të elementeve të mundshme të një marrëveshjeje politike, si dhe mundësisë së pasimit të një demarshi ndaj Beogradit, nga ana e ambasadorëve të SHBA-së, Ruisë dhe BE-së.⁴²

Pikëpamja e Qeverisë së SHBA-së ishte se duhej bërë presion ndaj sekretarit gjeneral të Kombeve të Bashkuara për lëshimin e raportit të tij për zbatueshmërinë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB 1199, jo më vonë se 5 tetor, si dhe bindjen e qeverive të Francës dhe Gjermanisë që

38 Po aty.

³⁹ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20844, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të drejtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 30 shtator 1998, 2:45 - 4:15 P.M., Uashington.

⁴⁰ "United Nations Security Council Resolution 1199 (1998)", adopted by the Security Council at its 3930th meeting, on 23 September 1998, qasur më 19.12.2022, <http://www.unscr.com/en/resolutions/1199>.

⁴¹ "Takimi i Drejtorëve Politikë të Grupit të Kontaktit në Londër, i datës 3 tetor 1998", "Report of the Secretary-General Prepared Pursuant to Resolutions 160 (1998) and 1199 (1998) of the Security Council" S/1998/912, 3 October, 1998, qasur më 19.12.2022, <http://reliefweb.int/report/serbia/kosovo-report-un-secretary-general>.

⁴² *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20844, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të drejtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 30 shtator 1998, 2:45 – 4:15 P.M., Dhoma e Situatës, Uashington.

ato të mos kërkonin më tutje pas këtij raporti, një Rezolutë të veçantë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.⁴³

Në kontekstin ushtarak, Qeveria e SHBA-së kishte qëndrim se Rusia duhej mbajtur edhe më tej në tryezë të trajtimeve për çështjen e Kosovës, mirëpo duke qartësuar se Aleanca, nëse është e nevojshme, do të ishte e gatshme të veprojë përkundër kundërshtimeve të Ruisisë. Objektivi i politikës së jashtme amerikane në këtë stad ishte sigurimi i marrëveshjes së NATO-s, më 7 tetor 1998, për autorizimin e lëshimit të “Urdhrit të Aktivizimit” (ACTORD) duke mbuluar si opsionin e limituar ajror, po ashtu edhe fushatën ajrore në faza.⁴⁴

Si pjesë e kësaj strategjie vepruese, në planin diplomatik, planifikohej dërgimi i ambasadorit Hollbruk në Beograd, menjëherë pas lëshimit të “Urdhrit të Aktivizimit” (ACTORD) dhe para ekzekutimit të sulmeve ajrore, për ballafaqim dhe prezantimin e këtij “Ultimatumi” Millosheviqit, me kërkesa të caktuara e të qarta, me synim të arritjes së pajtimit të plotë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB 1199.⁴⁵

Në këtë kuadër, për sigurimin e një balance të përgjithshme, në relacion me marrëdhëniet me shqiptarët e Kosovës, Qeveria e SHBA-së formuloi një porosi të fortë ndaj tyre dhe përcaktoi mënyrën e duhur për shqiptim, në mënyrë që të jenë në linjën e duhur pa shkaktimin e problemeve të paparashikueshme, në një periudhë kur ishte përcaktuar mundësia e sulmeve ajrore ndaj Beogradit. Po ashtu, Qeveria e SHBA-së pranoi planifikimin e NATO-s, pa zotim për një varg rrethanash të papritura tokësore që supozonin një mjedis tolerant, si dhe zhvillimin e implementimin e një strategjie për dobësimin e Millosheviqit.⁴⁶

Në këtë kohë, u ngrit niveli i trajtimit ditor në kuadër të “Komitetit për Kosovën” në NSC, për çështjet e ndërlidhura me mbikëqyrjen e aktiviteteve diplomatike e ushtarake. Pjesë përbërëse e këtyre takimeve, në formë alternative komunikuese, ishte edhe përfaqësuesi i përhershëm i SHBA-së në NATO, gjenerali Klark. Kjo kohë korrespondonte me fazën përfundimtare të përgatitjeve, të planeve ushtarake të veprimit për përkrahjen e përpjekjeve diplomatike, para nxjerrjes së “Urdhrit të Aktivizimit” të NATO-s. Po ashtu, në këtë kohë, shqyrtohej edhe

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty; Christopher Hill, “*Outpost: Life on the frontlines of American diplomacy*” (New York: Simon & Schuster, 2014), 140-143.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty.

strategjia për mënyrën e veprimit me aleatët, Kombet e Bashkuara, UÇK-në, shtetet fqinje (Maqedoni dhe Shqipëri) dhe Kongresin.⁴⁷

Kjo përpjekje, u shoqërua me një përgatitje gjithëpërfshirëse institucionale të SHBA-së, nëpërmjet nxjerrjes nga NATO-ja e “Urdhrit të Aktivizimit - ACTORD” për sulme ushtarake ajrore, në mënyrë që t’i mundësohet ambasadorit Hollbruk, kohë plotësuese për diskutimet e tij në Beograd.⁴⁸

Në këto konstelacione, objektiv i Qeverisë së SHBA-së⁴⁹ ishte dëgjueshmëria e qëndrueshme dhe e verifikuar ndaj Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në këtë aspekt, ishte qëndrim i NSC-së që Millosheviqi kishte ndërmarrë disa hapa në drejtim të akordimit, mirëpo, ai nuk kishte dëshmuar që ky akordim është real dhe jetëgjatë. Situata në terren në Kosovë ishte keqësuar dukshëm, duke shtyrë që në vazhdimësi të politikës së saj, Shtetet e Bashkuara të kërkojnë nga NATO-ja nxjerrjen e “Urdhrit të Aktivizimit -ACTORD”, deri më datë 10 tetor 1998.⁵⁰

Në planin ushtarak, SHBA-ja kishte marrë të gjitha përgatitjet e duhura, duke përfshirë ekzaminimin e gamës së plotë të opsioneve nga ana e NATO-s për zbatimin e marrëveshjes, si dhe forcën civile mbikëqyrëse, e bazuar në rritjen e Misionit të Vëzhguesve Diplomatikë të Kosovës (Kosovo Diplomatic Observer Mission - KDOM). Ishte politika udhëheqëse e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që kërkuan me ngulm marrëveshjen e NATO-s për një “Urdhër të Aktivizimit - ACTORD”, për “Opsionin e Limituar Ajror dhe Fushatën Ajrore në Faza”, duke pasur parasysh që këshillimi i mëtutjeshëm do të ishte i nevojshëm nga tranzicioni i Opsionit të Limituar Ajror në Fushatën Ajrore në Faza, si dhe në tranzicionin ndërmjet secilës fazë në këtë fushatë. Po ashtu, Shtabi i Komandantëve të Bashkuar, nën direktivat e NSC-së, njoftuan

⁴⁷ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20854, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendës drejtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 2 tetor 1998, 5:00 - 6:00 P.M., Uashington.

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20866, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të drejtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 5 tetor 1998, 2:30 - 4:00 P.M., Uashington.

⁵⁰ Po aty.

komandantin suprem të Forcave Aleate për Evropë (Supreme Allied Commander Europe - SACEUR), për zotimin e forcave të SHBA-së për Opsionin e Limituar Ajror dhe Fushatën Ajrore në Faza, dhe më pas nën mbikëqyrjen amerikane të lëshimit të “Urdhrit të Aktivizimit - ACTORD”.⁵¹

Administrata amerikane kishte gatishmëri e vendosmëri të plotë për fillimin dhe realizimin e sulmeve ajrore dhe ushtarake, deri me plotësimin e kushteve të dhëna Millosheviqit. Përkundër kësaj, ishte qëndrimi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së që para se Këshilli Verio-Atlantik të merr vendimin e “Urdhrit të Aktivizimit - ACTORD”, duhet të ketë një takim të Grupit të Kontaktit, në kuadër të konditave, që aleatët pjesë përbërëse e këtij organizmi, të jenë të gatshëm të aprovojnë “Urdhrit të Aktivizimit - ACTORD”, në mënyrë që t’i jepet edhe një mundësi përpjekjeve diplomatike.⁵² Para kërcënimit kredibil të NATO-s për bombardime ajrore të caqeve të forcave serbe dhe jugosllave në Kosovë dhe Jugosllavi, përfaqësuesi special për Kosovën Riçard Hollbruk, ndërmoi përpjekjet e fundit që ta bind Millosheviqin që të pranojë ndaljen e menjëhershme të luftimeve dhe mizorive ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Në këtë kuadër, u përcaktuan vijat e udhëzimeve të Departamentit të Shtetit, për ambasadorin Hollbruk, lidhur me takimet e ardhshme me Millosheviqin, me ç’rast i njëjti duhej ta pranonte të plotë “Ultimatumin” - parimet e përcaktuara nga SHBA-ja:

- ***Pajtueshmëri:*** insistim në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, për misionin e ambasadorit Hollbruk;

- ***Verifikim:*** kërkesë nga ana e SHBA-së për Millosheviqin që të pranojë një pako të fuqishme të verifikimit të ajrit dhe tokës së Kosovës;

- ***Qëndrueshmëri:*** kërkesë urdhëruese, nga administrata amerikane për Millosheviqin, që të pranojë një agjendë kohore konkrete për negociatën të bazuar në draft deklaratën e ambasadorit Hill. Po ashtu, që t’i bëhej e qartë se NATO-ja do ta mbante të drejtën e inicimit të operacioneve ushtarake ajrore kundër RFJ-së,

⁵¹ Po aty.

⁵² National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20865, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendësdrojtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 6 tetor 1998, 7:15 – 7:45 A.M., Uashington.

*nëse Millosheviqi do të dështonte të mbetej në pajtueshmëri me kërkesat e parashtruara nga SHBA-ja”.*⁵³

Pjesë e strategjisë vepruese amerikane ishte që inicimi i sulmeve ushtarake të NATO-s, nën udhëheqjen e SHBA-së, të ndërlihej me objektivin themelor në këtë periudhë kohore, atë të dëgjueshmërisë së plotë dhe të qëndrueshme të Beogradit ndaj Rezolutës 1199 të KS të OKB-së.⁵⁴ Në këtë kontekst, qëndrimi i politikës amerikane për interesat e relacioneve ndërkombëtare, ishte se për shkak të pozicionit të Rusisë dhe rolit të saj në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të dekurajoheshin aleatët nga kërkesat e mëtejshme për një rezolutë të veçantë të Këshillit të Sigurimit që specifikonte autorizimin e përdorimit të forcës. Po ashtu, u la mundësia që nëse aleatët dëshironin ta “testonin” gatishmërinë e Rusisë që të pajtohej me këtë lloj rezolute, SHBA-ja pajtohej për një qasje të tillë, mirëpo, me kusht që ato ta bëjnë këtë në shpejtësi dhe në heshtje.⁵⁵

Këshilli i Sigurisë Kombëtare, në mbledhjet për Kosovën, trajtoi edhe bazën juridike për veprimin e NATO-s; skicimin e vendimit që autorizonte ACTORD (Urdhër Aktivizimin) dhe cilin do vendim tjetër që ndërlihej me vendosjen e NATO-s në kohën përkatëse; planin e evakuimit i cili do të merrte në konsideratë Kombet e Bashkuara, misionet diplomatike të aleatëve dhe ato miqësore, OJQ-të dhe shtetasit e RFJ-së të cilët ishin të lidhur me programet e sponsoruara nga SHBA-ja; rikonfirmimin e kohës së largimit të urdhëruar dhe mbylljes përfundimtare të Ambasadës; përmirësimin e planit të Grupit Punues Ndërinstitucional (IWG) të Kosovës, duke përfshirë Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s për përkrahjen e KVM, me forca të reagimit të shpejtë në horizont.⁵⁶

Po ashtu, në vazhden e planifikimit për themelimin e KVM-së, u definua qëndrimi amerikan lidhur me marrëdhëniet ndërmjet NATO-s dhe

⁵³ Po aty.

⁵⁴ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20867, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të drejtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 6 tetor 1998, 2:15 – 4:00 P.M., Uashington.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20871, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendësredjtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 7 tetor 1998, 2:45 – 3:50 P.M., Uashington.

Misionit Verifikues të Kosovës (KVM), që të jetë ai i koordinimit dhe jo i kontrollit, si dhe i përkrahjes së KVM-së me administratë, logjistikë, komunikim dhe inteligjencë, sikurse edhe për ofrimin e Forcës së Intervenimit të Shpejtë, në rrethana të jashtëzakonshme. Regjimi Verifikues që duhej të zbatohet, u përcaktua që të ishte i përshtatshëm për shqiptarët e Kosovës, si dhe dokumentet e Misionit Verifikues të Kosovës nga Grupi Punues Ndërinstitucional për Kosovën, duke përfshirë njoftimin në një nivel të përgjithshëm për aleatët, me miratim përfundimtar nga NSC-ja. Në këtë prizëm u hartua edhe nga Departamenti i Shtetit, udhëzuesi për përfaqësuesin e posaçëm Hollbruk, duke përfshirë dokumentet e KVM-së, për përcaktimin e atë që SHBA-ja kërkoi në aspektin e marrëveshjes, nga Millosheviqi.⁵⁷

Me qëllim të mbrojtjes së informacionit dhe ndërmarrjes së tërësishme të sulmeve ushtarake ajrore ndaj Beogradit, administrata amerikane ndërmori një sërë masash, duke përfshirë zgjidhjen me Francën të pozicionit të saj lidhur me kërkesën për vendimin e dytë që pasonte “ACTORD” dhe para ekzekutimit të sulmeve ajrore, si dhe udhëzimin e Shtabit të Komandantëve të Bashkuar që të kërkonin nga SACEUR të minimizonte për aleatët, lëshimin e informacioneve të shënjitimit.⁵⁸

Periodha ndërmjet 9 deri 13 tetor 1998, ka qenë qenësore për fatin e inicimit të intervenimit ushtarak të NATO-s në Kosovë, respektivisht për dhënien e mundësisë për zgjidhje paqësore. Ishte pikëpamje e SHBA-së se Misioni Verifikues në teren, do t'i jepte një mundësi reale zgjidhjes së problemit të Kosovës nëpërmjet marrëveshjes politike. Përfaqësuesi special Riçard Hollbruk, sipas udhëzimeve të NSC-së të SHBA-së, e paraqiti “Ultimatumin e Presidentit Klinton” dhe i ndërmori përpjekjet e fundit që ta bind Millosheviqin për pranimin e ndaljes së luftimeve dhe mizorive, para kërcënimit kredibil të NATO-s për bombardime ajrore të caqeve të forcave serbe dhe jugosllave në Kosovë, Serbi dhe RFJ.⁵⁹

⁵⁷ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20874, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendësdrojtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 8 tetor 1998, 8:00 – 9:00 A.M., Uashington.

⁵⁸ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20885, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendësdrojtorëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 9 tetor 1998, 5:00 – 6:25 P.M., Dhoma e Situatës, Uashington.

⁵⁹ Arbër Hadri, “Këshilli i Sigurisë Kombëtare i SHBA-së: Lufta në Kosovë”-

Në këtë drejtim, Shtabi i Komandantëve të Bashkuar dhe CIA, nën udhëheqjen e NSC, përcaktuan një sërë kërkesash specifike për tërheqjen e Ushtrisë Jugosllave dhe Forcave Policore (MVP), për shfrytëzimin nga ana e ambasadorit Hollbruk, si dhe gjeneralit Klark, në Beograd më 15 tetor 1998. Me këtë rast, u ngarkua Departamenti i Shtetit për përgatitjen e një draft-rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për miratimin e Misioneve Verifikuese të OSBE-së dhe NATO-s, si dhe diskutimet me Rusinë, për participimin rus në misionet verifikuese të OSBE-së dhe NATO-s, duke përfshirë edhe përpunimin e menjëhershëm të çështjes së kombit sponsore, madhësisë dhe lokacionit të Forcës për Reagim të Shpejtë të NATO-s.⁶⁰

Këto veprime të diplomacisë shtrënguese dhe kërcënimit real me forcë ushtarake, nëpërmjet “Ultimatimit të Presidentit Klinton” dhe “Urdhrit të Aktivizimit” të NATO-s, dhanë rezultat tërheqjen e Serbisë dhe miratimin e “Marrëveshjes parimore ndërmjet Hollbrukut dhe Millosheviqit”. Marrëveshja rezultoi me ndaljen e fillimit të sulmeve ushtarake ajrore të SHBA-së dhe NATO-s kundër Serbisë. Mirëpo në të njëjtën kohë, përkundër këtyre lehtësimeve, u mbajt mburoja diplomatike nga ana e administratës amerikane, si dhe u realizuan përgatitjet e nevojshme ushtarake, gjatë periudhës verifikuese të kësaj marrëveshjeje.⁶¹

Në planin diplomatik u ngarkua ambasadori Hill që të qëndrojë në Beograd dhe të bëjë presion ndaj Millosheviqit, në fushat e mbetura të mosbindjes, të identifikuar nga CIA. Në këtë aspekt, nëse RFJ-ja do të ishte në bindje të konsiderueshme deri më 27 tetor 1998, qëndrimi i Shteteve të Bashkuara konsistonte në paraqitjen e kërkesës për një vendim të Këshillit Verio-Atlantik (NAC) që do ta linte komandantin suprem të Forcave Aleate për Evropë (SACEUR) gjeneralin Klark, me kompetencat ekzistuese që të ekzekutonte sulmet ajrore, nëse NAC gjykonte se RFJ-ja ka dështuar të bënte përparim të vazhdueshëm në drejtim të bindjes së plotë, apo nëse kishte degradim të konsiderueshëm në bindjen vepruese të RFJ-së.⁶²

“Dokumente shtetërore-publike të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së: Kosova Vëllimi I, 19 qershor 1998-31 tetor 1998” (SHBAH, Prishtinë, 2020), 50-56.

⁶⁰ Po aty, 55-57.

⁶¹ Po aty, 55-65.

⁶² *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20936, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendësrejtoreve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 26 tetor 1998, 10:30 - 12:00 P.M., Uashington, Pika 1 & 2.

Në këtë kohë, në prag të përcaktimit të vlerësimin dhe pranimit të faktit të bindjes së RFJ-së, u bënë edhe përgatitjet nga ana e NSC-së për kthimin e personave të zhvendosur dhe hapave të mëtejme të presionit, përgatitjeve dhe veprimeve ushtarake, diplomatike dhe relacionit me publik.⁶³

Në prag të skadimit të ultimatumit më 27 tetor 1998,⁶⁴ u vlerësua nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, se ekzistonte bindje e konsiderueshme e RFJ-së bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, mjaftueshëm sipas pikëpamjes së Administratës Amerikane që NATO-ja të ndalojë në atë kohë, fillimin e sulmeve ajrore. Po ashtu, qëndrimi i administratës amerikane ishte që thelbësore për bindjen e vazhdueshme ishte përmbajtja e UÇK-së dhe në këtë kontekst u ngarkua Departamenti i Shtetit që të zhvillojë një strategji të fokusuar për përfshirjen e UÇK-së në zgjidhjen paqësore. Si pjesë e këtij qëndrimi, u udhëzua Departamenti i Shtetit, që të kontaktonte me anëtarët me influencë të komunitetit shqiptaro-amerikan, për ushtrimin e influencës së tyre për këtë çështje.⁶⁵

Shtabi i Komandantëve të Bashkuar u autorizua që më 3 nëntor 1998 të rirreshtojë Aeroplanët B-52 nga Mbretëria e Bashkuar në Bazën amë, si dhe që ambasadori Hill të bënte presion te Millosheviqi për tërheqjen plotëse të Forcave Policore Serbe nga Kosova.⁶⁶

Në përfundim të këtij punimi mund të konkludojmë se politika e jashtme amerikane ndaj Kosovës, në periudhën e intensifikimit të luftimeve në Kosovë në pjesën e dytë të vitit 1998, ishte e përqendruar në ndaljen e luftës dhe të akteve mizore të ushtrisë serbe, lehtësimin humanitar për popullatën, si dhe gjetjen e një zgjidhjeje politike paqësore për çështjen e statusit politik të Kosovës.

⁶³ Po aty.

⁶⁴ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20929, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendësrejtoreve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 27 tetor 1998, 10:30 a.m. - 12:00 p.m., Dhoma e Situatës, Uashington.

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ *National Archives (National Historical Publications and Records Commission – NARA) - Clinton Presidential Library*, Dosja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (National Security Council – NSC), Doc 20959, Përmbledhje e konkludimeve të mbledhjes së Komitetit për Kosovën të zëvendësrejtoreve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, 30 tetor 1998, 4:30 – 6:30 P.M., Uashington.

Në këtë kuadër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës si superfuqia e vetme botërore, vepruan duke shfrytëzuar potencialin diplomatik, ushtarak dhe mekanizmat shtetëror në institucionet ndërkombëtare NATO, OSBE, OKB dhe Grupin e Kontaktit, që aleatët e saj dhe bashkësia ndërkombëtare ta kenë një zë në atë situatë, si dhe të ushtrojnë tryzni genësore ndaj regjimit serb të Millosheviqit për parandalimin e eskalimit të mëturjes së luftës dhe akteve gjenocidiale ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Përkundër përpjekjeve të pareshtura diplomatike, Serbia në krye me Millosheviqin nuk ndalej në ushtrimin e dhunës në terren në Kosovë, që rezultoi me fillimin e përgatitjeve të administratës amerikane për mundësinë e përgjigjes me intervenim ushtarak, nëse nuk pranoheshin kushtet e bashkësisë ndërkombëtare.

Situata rrënuese në Kosovë, përfshiu kreun më të lartë të SHBA-së presidentin, si dhe Këshillin e Sigurisë Kombëtare. Në këtë kontekst, sipas rekomandimeve të Këshilltarit për Siguri Kombëtare Berger, NSC-së dhe gjeneralit Klark, presidenti Klinton miratoi më 24 shtator 1998, ultimatumin dhe përgatitjet e nevojshme për intervenim ushtarak në Kosovë, si dhe të një strategji të ndërlidhur diplomatike. Ky akt vërtetoi përkushtimin amerikan për ndaljen e katastrofës humanitare në Kosovë në prag të dimrit, si dhe që vetëm rrjedhat diplomatike parandaluan një veprim të tillë në këtë kohë. Si pjesë e këtij përkushtimi ishte edhe angazhimi i misionit amerikan në NATO, për nxjerrjen e “Kërkesës për Aktivizim” dhe “Urdhrit të Aktivizimit”, që autorizonte Komandantin Suprem të Aleatëve në Evropë, gjeneralin Klark, për iniciimin e përshkallëzuar të sulmeve ajrore me raketa të dirigjuara dhe avionë ndaj Serbisë dhe ushtrisë së saj.

Në këto konstelacione, objektiv i administratës amerikane ishte dëgjueshmëria e qëndrueshme dhe e verifikuar e Serbisë ndaj Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Përpjekjet e fundit të diplomacisë amerikane për arritjen e një zgjidhjeje diplomatike para përfshirjes ushtarake të NATO-s në Kosovë, me qëllim të ndaljes së luftimeve në terren, si dhe kthimit të të përndjekurve në shtëpitë e tyre, rezultuan me sukses. Diplomacia shtrënguese e shoqëruar me kërcënimin kredibil të përdorimit të forcës, e udhëhequr nga përfaqësuesi special për Kosovën, ambasadori Hollbruk, ndikuan në plotësimin e kushteve të “Ultimatimit të Presidentit Klinton” nga ana e Serbisë, me ç’rast u ndal fillimi i sulmeve ajrore të NATO-s në fund të tetorit 1998. Nënshkrimi i “Marrëveshjes Hollbruk-Millosheviq”, që konsistonte në tërheqjen e forcave ushtarake serbe, ndaljen e luftimeve në Kosovë, përmirësimin e

gjendjes humanitare në terren, krijimin e një mekanizmi të ndalim fluturimit ajror mbi Kosovë dhe verifikimit tokësor të armëpushimit, si dhe përkrahjes së procesit negociator të paqes, rezultoi që Shtetet e Bashkuara të pezullojnë përkohësisht sulmet ushtarake ajrore ndaj Serbisë dhe u përqendruan në gjetjen e një zgjidhjeje diplomatike për çështjen e Kosovës.

Arbër HADRI

SUMMARY

**PRESIDENT BILL CLINTON ULTIMATUM: PREPARATION
FOR MILITARY INTERVENTION IN KOSOVO
(SEPTEMBER-OCTOBER 1998)**

United States foreign policy towards Kosovo, during the period of intensification of fighting in Kosovo, during the second half of 1998, was focused on ending the war and carnage by the Milosevic Serbian army and police, providing humanitarian relief for the population, and peaceful conclusion of political status of Kosovo. This paper, based on principal historical documents, derived from the highest American government institution for foreign policy and national security, "National Security Council" (NSC), involved at that time to resolve this conflict. The issue of NATO's military intervention in Kosovo, due to the humanitarian disaster on the ground, was placed on the priority list of American Administration.

This agenda was on the rails of political and military decision, and interagency bodies, such as the United States Mission to NATO were also involved in the effort, in order to commence the formal process of initiating military aerial operations, launching guided missile attacks. The aim was, in line with coercive diplomacy and real military threat, to issue an "Ultimatum" to Milosevic, as well as finalizing military preparations, such as securing NATO authorization to issue the "Activation Request" (ACTREQ) and "Activation Order" (ACTORD) for all air operations, through military intervention, as well as the development of the "light" ground option for the implementation of peace agreement. At the end of October 1998, NATO bombings were stopped after Serbia agreed to the conditions of "President Clinton's Ultimatum." The signing of the Holbrook-Milosevic Agreement, which consisted in the withdrawal of Serbian military forces, the cessation of fighting in Kosovo, the improvement of the humanitarian situation on the ground, "no fly zone" over Kosovo and ground verification of the ceasefire, as well as support for the peace negotiation process, resulted that United States temporarily suspended military air strikes against Serbia and focused on finding a diplomatic solution to the Kosovo issue.